



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:038026

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05629978

KPPP.nr.2121/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Banka Ekonomike” me numër biznesi 80117029, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Credit Link” LLC, me seli në Prishtinë, Bulevardi “Nëna Terezë” nr.31/1/1, kundër debitorëve 1. N.T. “Qëndresa”, me seli në Pejë, rr. “Gani Daci 2” të cilën e përfaqëson F.K. me numër personal ... dhe 2. D.K. me numër personal ... nga Peja rr. “...”, duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 29/2022 të datës 27.01.2022 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani me seli të zyrës në Prizren, dhe ankesës për parregullsi të datës 07.03.2023, me datë 26.04.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar ankesa për parregullsi e ushtruar nga debitorët 1. NT. “Qëndresa”, të cilën e përfaqëson F.K. dhe 2. D.K. e datës 07.03.2022, me të cilën ka kërkuar zhblokimin e xhirollogarive bankare deri në marrjen e aktvendimit të plotfuqishëm nga gjykata.
- II. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorëve NT. “Qëndresa”, të cilën e përfaqëson F.K. dhe D.K., SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 29/2022 i datës 27.01.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani me seli të zyrës në Prizren, mbi bazën e dokumentit përmbartimor, Marrëveshjes mbi Pengun dhe Konfirmimit të Regjistrimit të Pengut Nr. R-20200914-107 të datës 14.09.2020 lidhur me Veturën “Mercedes Benz” me numër identifikues ..., ndërsa MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 29/2022 të datës 27.01.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Banka Ekonomike” ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.29/2022 të datës 27.01.2022, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues Marrëveshjes mbi Pengun dhe Konfirmimin e Regjistrimit të Pengut Nr. R-20200914-107 të datës 14.09.2020 deri më 14.09.2023, duke detyruar debitorët që t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,988.37€ (dymijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë euro e tridhjetë e shtatë cent), përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorëve nëpër të gjitha bankat komerciale si dhe sekuestrimi i kolateralit i cili përbëhet nga vetura “BMË” X5 në vlerë prej 15.000€, veturën “Mercedes Benz” në vlerë prej 5.500€, veturë “Skoda” në vlerë prej 2.000€, veturë “Citroen” Jumper në vlerë prej 1.500€, Lager Lista në vlerë prej 16.987€. sipas listës së pengut Nr.9376 të datës 24.10.2014.

Debitorët brenda afatit ligjor, kanë paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarime me arsyetimin se i njëjti është në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, pasi që në dokumentin përmbarimorë nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, ndërsa kreditori nuk ka paraqitur deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke treguar edhe ditën kur e njëjta është bërë e kërkueshme. Tutje ka theksuar se urdhri përmban gabime thelbësore pa mënjanimin të cilave nuk mund të vazhdohet kjo procedurë përmbarimore, Andaj i ka propozuar gjykatës që duke qenë se urdhri përmbarimor është i parakohshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të njëjtin ta hedh poshtë si të pasafatshëm apo të palejuar.

Përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor ka paraqitur kreditori, i cili ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorëve duke shtuar se dokumentet në bazë të së cilave është iniciuar procedura përmbarimore janë dokumente përmbaruese me titull ekzekutiv. Ka kundërshtuar edhe pretendimet e debitorëve mbi kërkueshmërinë e kredisë duke shtuar se debitorët janë vizituar me datën 14.11.2021 për arritjen e ndonjë marrëveshje për shlyerjen e borxhit mirëpo të njëjtin kanë refuzuar, si dhe në mënyrë të vazhdueshme janë përmes thirrjeve telefonike është kërkuar përmbushja e detyrimit. Tutje ka theksuar se me datë 19.01.2022 i është dërguar letër vërejtja për pagesën e borxhit mirëpo debitorët sërish kanë dështuar ta përmbushin detyrimin. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorëve.

Debitori më 07.03.2022 ka ushtruar ankesë kundër pa rregullsive me rastin e kryerjes së përmbarimit, ku pretendon se në mënyrë të kundërligjshme organi përmbarimorë ka bërë

bllokimin e xhirollogarive bankare të debitorëve ende pa u vendosur nga gjykata në lidhje me prapësimin e debitorëve.

Përgjigje në ankesë më datë 15.03.2022 ka ushtruar kreditori i cili ka theksuar se urdhri përmbartimorë është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se ankesa ka për qëllim vetëm zvarritjen e procedurës.

Lidhur me ankesën Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani, përmes akt përcjellësit ka theksuar se organi përmbartimor ka vepruar në përputhje me nenin 67 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, ku sipas tij përcaktohet se pengu sekuestrohet pa njoftim paraprak.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në ankesën për parregullsi të datës 07.03.2022, deklaramentit të përmbartuesit privat dhe vlerësimin të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 79 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se ankesa për parregullsi e debitorit është në tërësi e pabazuar andaj të njëjtën e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimin të provave që gjenden në shkresat e lëndës gjeti se organi përmbartues/përmbartuesi privat nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim përmbartimor në mënyrë të parregullt dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Sipas vlerësimin të gjykatës, përmbartuesi privat ka vepruar në përputhje me nenin 48 të LPP-së i cili përcakton se: *“1. Përmbartimi zbatohet edhe para se aktvendimi për përmbartimin apo urdhri për përmbartim të bëhet i formës së prerë, në qoftë se për veprimet e caktuara përmbartimore nuk është paraparë diçka tjetër”*.

Andaj në këtë rast përmbartuesi privat ka bllokuar llogaritë bankare të debitorëve me qëllim të sigurimit të pengut të përcaktuar sipas Konfirmimin e Regjistrimit të Pengut Nr. R-20200914-107 të datës 14.09.2020 deri më 14.09.2023 në përputhje edhe me nenin 167 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, i cili përcakton se: *“1. Pengmarrësi i pengut pa posedim mund të paraqesë një kërkesë në gjykatën kompetente, që pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e pengdhënësit apo personave të tjerë atë ta autorizojë që sendin e lënë peng ta sekuestrojë dhe t’ia dorëzojë pengmarrësit. Rreth kësaj kërkesë gjykata duhet të vendosë më së voni pesë (5) ditë pune pas datës së paraqitjes së kërkesës. 2. Pengdhënësi ose debitori i kërkesës së siguruar, nëse ky nuk është njëkohësisht pengdhënësi, mund të paraqesë kërkesë në gjykatën kompetente që të*

konstatohet se, e drejta e pengut është e pavlefshme tërësisht apo pjesërisht. Nëse gjykata vendos një konstatim të tillë, ajo duhet njëkohësisht të vendosë a do ta abrogojë apo do ta ndryshojë vendimin e nxjerrë në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni , dhe nëse vendos kësisoj, duhet të vendosë nëse pengmarrësi përgjigjet dhe në cilën shumë përgjigjet për dëmin që është shkaktuar përmes vendimit për sekuestrimin apo dorëzimin e sendit të lënë peng tek pengmarrësi.”.

Andaj, meqenëse gjykata, nuk ka gjetur se ndonjë veprim përbarimor është kryer në mënyrë të parregullt dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, nga ana e përbaruesit privat, e të cilat do të ia cenonin dinjitetin e debitorit, gjykata vlerëson se përbaruesi privat me veprimet e ndërmarra nuk ka kryer asnjë parregullsi dhe se i njëjti ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP-së, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi pjesërisht dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore përcaktohet se dokument përbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*.

Gjykata vlerësoi dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi dhe gjeti se Marrëveshjes mbi Pengun në shkresa të lëndës është paraqitur në kopje të noterizuar pranë zyrës noteriale të noterit Arësim Avdijaj. Përmes marrëveshjes gjykata gjeti se janë lënë peng “BMW X5 në vlerë prej 15.000€, veturën “Mercedes Benz” në vlerë prej 5.500€, veturë “Skoda” në vlerë prej 2.000€, veturë “Citroen” Jumper në vlerë prej 1.500€, Lager Lista në vlerë prej 16.987€, sipas listës së pengut Nr.9376 të datës 24.10.2014, mirëpo jo të gjitha janë regjistruar pranë organit kompetent

Nga Konfirmimi i regjistrimit të Pengut Nr. R-20200914-107 të datës 14.09.2020 deri më 14.09.2023, gjykata gjeti se janë regjistruar vetëm vetura “BMW” X5 në vlerë prej 15.000€,

vetura “Skoda” në vlerë prej 2.000€, vetura “Citroen” Jumper në vlerë prej 1.500€ dhe Lager Lista në vlerë prej 16.987€, ndërkaq vetura “Mercedes Benz” në vlerë prej 5.500€, pjesë e marrëveshjes së pengut nuk është regjistruar.

Andaj gjykata shfuqizoi Urdhrin Përmbartimor P.nr. 29/2022 të datës 27.01.2022 mbi bazën e dokumentit përmbartimor, Marrëveshjes mbi Pengun dhe Konfirmimit të Regjistrimit të Pengut Nr. R-20200914-107 të datës 14.09.2020 lidhur me Veturën “Mercedes Benz” me numër serial

Ndërkaq la në fuqi urdhrin përmbartimorë të datës 27.01.2022 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani, mbi bazën e dokumentit përmbartimorë, Marrëveshjes mbi Pengun dhe Konfirmimit të Regjistrimit Nr. R-20200914-107 të datës 14.09.2020, pasi që gjeti se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi është paraqitur në formën e kërkuar ligjore, në përputhje me nenin 38 par. 1 të LPP-së, se: *1. Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit.”.*

Sa i përket pretendimit të debitorëve mbi kërkueshmërinë e kredisë, gjykata gjeti se nga pasqyra e obligimeve e datës 12.11.2018 e lëshuar nga kreditori, debitori ka rënë në vonesë, andaj në përputhje me nenin 305 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se: *“1. Debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje. 2. Në qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori ta ftojë që ta plotësojë detyrimin e vet, verbalisht ose me shkrim, paralajmërim jashtë gjyqësor, ose duke filluar ndonjë procedurë, qëllimi i së cilës është realizimi i përmbushjes të detyrimit.”.*

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2121/23, datë 26.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.